



SHQIPËRIA NDIHMON GRACANICËN

13 Maj 2010 11:28

Komuna e Graçanicës dhe Fondi shqiptar i Zhvillimit nënshkruan sot në orët e paraditës, marrëveshjen për implementimin e donacionit në vlerë prej 400 mijë eurosh, para këto kryeministri Sali Berisha i pati premtuar ndihmë komunës se re në dhjetor të vitit të kaluar. Me këto mjete është paraparë që të bëhet rikonstruktimi i një stadiumi, i çezmës së komunës, rregullimi i rrugës pranë manastirit të Graçanicës, si dhe rregullimi i rrjetit të ujërave të zeza. Të dy palët nënshkruese këtë akt e kanë cilësuar si një shenjë të mirë dhe fillim të ri në marrëdhëniet në mes tyre.